


LETËR KREDIA

Letër Kredia është një instrument pagese në formën e një angazhimi të pakthyeshëm të bankës lëshuese.

Letër Kredia lëshohet në emër të blerësit/ importuesit (i quajtur ndryshe aplikanti), në favor të shitësit/ eksportuesit (i quajtur ndryshe përfituesi) për kryerjen e pagesës së mallrave / shërbimeve.

Pagesa e Letër Kredisë do të kryhet kundrejt paraqitjes së dokumenteve sipas kushteve të përcaktuara në të.

Bankat kujdesen që dokumentacioni i paraqitur në Letër Kredi të jetë në përputhje me kushtet që specifikohen në të. Ato nuk mund të jenë përgjegjëse për ndonjë mospërputhje mes mallrave/ shërbimeve dhe dokumenteve të paraqitura për Letër Kreditin.



▪ KONFIRMIMI I LETËR KREDISË

1. Letër Kredi e pakonfirmuar - mbart vetëm angazhimin e bankës lëshuese për pagesë.
2. Letër Kredi e konfirmuar – me kërkesë të përfituesit përveç angazhimit të bankës lëshuese për të paguar shtohet edhe angazhimi i një banke tjetër (banka konfirmuese).

▪ MËNYRAT E PAGESËS

1. Pagesë e menjëhershme - pagesa kryhet menjëherë nga banka kundrejt paraqitjes së dokumenteve të rregullta.
2. Pagesë e vonuar (e shtyrë) – pagesa kryhet në një datë të mëvonshme sipas kushteve të vendosura në Letër Kredi..
3. Pagesë mikse – kombinohen të dy mënyrat e mësipërme, një pjesë e pagesës është e menjëhershme kurse pjesa tjetër është pagesë e vonuar (e shtyrë).

Letër Kredia është subjekt i Rregullave Standarte dhe Praktikës për Kreditë Dokumentare (UCP nr.600), botim i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris, të cilat janë në fuqi nga data 1 Korrik, 2007.

Kolaterali i nevojshëm dhe kostot do të vlerësohen rast pas rasti. Për më shumë informacion ju lutemi të drejtoheni pranë sporteleve të bankave.